



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

## **RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS**

**Pakoja për nominimin e një (1) anëtari të Bordit  
të Radio Televizionit të Kosovës për komunitetin  
shqiptar**

**LIGJI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Nr. 04/L-046**

Dhjetor 2017  
[www.rtklive.com](http://www.rtklive.com)

## **PËRMBAJTJA**

<b>Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>Kush është themelues i RTK-së? .....</b>	<b>3</b>
<b>Organet drejtuese dhe të udhëheqjes të RTK-së.....</b>	<b>3</b>
<b>Kompetencat e anëtarëve të Bordit të RTK-së.....</b>	<b>4</b>
<b>Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të RTK-së.....</b>	<b>5</b>
<b>Pamundësia për të qenë anëtarë Bordit të RTK-së.....</b>	<b>5</b>
<b>Si të aplikohet për anëtarë të Bordit të RTK-së.....</b>	<b>6</b>
<b>Afati për dorëzimin e Aplikacioneve .....</b>	<b>7</b>

## Hyrje

Ligji është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 29.03.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL-012-2012, më datë 12.04.2012. Ligji është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr 7 /, më 27 Prill 2012 dhe ka hyrë në fuqi më 12 Maj 2012.

Në Nenin 40 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës përcaktohet sikur në vijim: Vazhdimësia e RTK-së: Që nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji RTK vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e vetë me autorizime të përcaktuara me ligj. Me fillimin e zbatimit të këtij ligji, Bordi aktual dhe Menaxhmenti aktual i RTK-së do të vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e përcaktuara nga ky ligj deri në zgjedhjen e anëtareve të rinj sipas këtij ligji.

Neni 3 i Ligjit për RTK-në përcakton që Radiotelevizioni i Kosovës është Transmetues Publik i Kosovës, me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme i cili ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore. RTK ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.

### **Kush është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës?**

Në bazë të Ligjit për RTK-në /Neni 4/ Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të Radiotelevizionit të Kosovës, të përcaktuar me këtë ligj.

### **Organet drejtuese dhe të udhëheqjes të RTK-së**

Në bazë të Nenit 24 të Ligjit të RTK-së, organet drejtuese dhe udhëheqëse të RTK-së janë: Bordi i RTK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Bordi i RTK-së është organ kolegjal-drejtues i RTK-së dhe përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. Anëtarët e Bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknikës.

Anëtarët e Bordit duhet të jenë individë me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral. Gjatë punës së tyre, anëtarët e Bordit duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm. Anëtarët e Bordit emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë RTK-së përveç interesit të publikut. Ata nuk lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë instruksion në lidhje me aktivitetet e Bordit nga asnjë interes jashtë RTK-së.

Anëtari i Bordit ose anëtari i ngushtë i familjes së tij nuk guxon të ushtroj veprimtari afariste me institucionin publik të RTK-së

Përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtar të Bordit të RTK-së emërohen nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar emërohet nga komunitetet tjera jo shumice dhe së paku dy (2) anëtar të jenë të gjinisë femërore. Të paktën dy (2) anëtarë të Bordit do të kenë kualifikime profesionale në fushën e financimit, menaxhimit biznesor dhe të drejtësisë.

### **Kompetencat e anëtarëve të Bordit të RTK-së**

Bordi i RTK-së, punon dhe vepron në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të statutit të RTK-së.

Në bazë të Nenit 29 të Ligjit për RTK-në, kompetencat e Bordit të RTK-së janë:

1. E aprovon statutin e RTK-së;
2. E aprovon rregulloren e punës së bordit si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me statut;
3. Shqyrton dhe miraton programet, bazat dhe standardet programore në përputhje me politikën programore, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të informimit publik sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm;
4. Shqyrton dhe miraton projekt-programin e produksionit të RTK-së i cili duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
5. Shqyrton dhe miraton skemën e përgjithshme programore;
6. Emëron dhe shkarkon, drejtorin e përgjithshëm të RTK-së,
7. Emëron dhe shkarkon zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e shërbimeve të përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm;
8. Miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së;
9. E shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim;
10. Shqyrton dhe publikon më së largu deri më 31 mars të çdo viti raportin financiar vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve për vitin paraprak të përgatitur nga menaxhmenti i RTK-së i cili i nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Raporti në fjalë më pas i dërgohet Themeluesit për trajtim dhe veprim;
11. Miraton plan programin vjetor, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;
12. Miraton kodin e mirësjelljes për RTK-në dhe siguron zbatimin efektiv të saj;
13. Mbikëqyrë paanshmërinë, objektivitetin dhe saktësinë e informacionit në programin e RTK-së;
14. Miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;
15. Siguron që janë ndërmarrë masat korigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme;
16. Vendos edhe për çështje të tjera të rëndësishme në përputhje me autorizimet dhe kompetencat që ka me ligj dhe statut.

## Zgjedhja e anëtarëve të Bordit

Në bazë të Nenit 26 të Ligjit të RTK-së, anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.

Kandidatët për Bordin të RTK-së propozohen sipas procedurave të mëposhtme:

1. Brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, RTK bënë shpallje publike brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj.
2. Pesë (5) ditë pas mbylljes së shpalljes publike, të gjitha aplikacionet RTK ia dorëzon Kuvendit të Kosovës i cili themelon Komisionin ad – hoc për shqyrtimin e tyre.
3. Brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë në Bord, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e RTK-së.
4. Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

## Pamundësia për të qenë anëtar i Bordit të RTK-së

Në bazë të Nenit 27 të Ligjit për RTK-në, anëtarë të Bordit të RTK-së nuk mund të jenë:

1. anëtarët e familjes së ngushtë të stafit menaxhues
2. ish punonjësit të punësuar në RTK në dy (2) vitet e fundit;
3. personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funksionarët publik) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
4. është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
5. është anëtar i organit udhëheqës të ndonjë ndërmarrje publike;
6. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit;
7. të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;
8. pronarët apo bashkëpronarët e mediejeve transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media;
9. është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit siç është përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

## Si të aplikohet për anëtarë të Bordit të RTK-së

Ligji për RTK-në i mundëson çdo individ i cili i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara me Ligj që të aplikoj për anëtarë të Bordit të RTK-së. Në bazë të Nenit 26 të Ligjit për RTK-në, procedurat për aplikim janë të paraqitura në vijim:

1. Pas shpalljes publike, RTK i vë në dispozicion të gjithë të interesuarve Pakon për Aplikim e cila përmban të gjitha udhëzimet e nevojshme për aplikim.
2. Kandidatët e interesuar duhet bashkengjitur edhe dokumentet në vijim:
  - Një kopje të CV-së;
  - Një Letër Motivuese;
  - Një kopje të letërnjoftimit;
  - Një kopje të çertifikatës së lindjes;
  - Dëshmitë e kualifikimit;
  - Dëshmi që nuk është nën hetime;
  - Tre letra të referencës.

## Afati për dorëzimin e Aplikacioneve

Dorëzimi i dokumentacionit të kompletuar për aplikim për anëtarë të Bordit të RTK-së, mund të bëhet prej datës **08 Dhjetor 2017 deri më 22 Dhjetor 2017, deri në orën 16:00.**

Aplikacionet **duhet të dorëzohen personalisht** (jo përmes postës elektronike), në kovertë të mbyllur, në ndërtesën e RTK-Televizionit të Kosovës, në Zyrën e Administratës nr. 71, Rr. Xhemajl Prishtina 12, 10000 Prishtinë.

- Pyetjet rreth procedurave dhe kushteve për aplikim, mund të parashtrohen përmes telefonit në 038 230 119 dhe përmes e-mailit në [administrata@rtklive.com](mailto:administrata@rtklive.com).

## **I. Formulari i deklaratës së nominuesit**

[Të kompletohet nga nominuesi si individ]

**Unë, në emrin tim personal;**

---

[shëno emrin dhe mbiemrin me shkronja të shtypit]

me vendbanim në \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_

numër telefoni \_\_\_\_\_ mobili \_\_\_\_\_

fax \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_

si banor i ligjshëm i Kosovës (dëshmuar me kopjen e dokumentit të identifikimit)

**Nominoj për anëtarë të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës:**

---

*(emri dhe mbiemri i të nominuarit)*

---

**Nënshkrimi i nominuesit**

**Data**

## II. Formulari i deklaratës së nominuesit

[Të kompletohet nga organizata/i autorizuar i organizatës si nominues]

**Organizata**

---

[shëno emrin e plote te organizates me shkronja të shtypit]

**Përfaqësuar nga** \_\_\_\_\_  
(emir dhe mbiemri i te autorizuarit)

**Organizata me seli në** \_\_\_\_\_ **rruga** \_\_\_\_\_

**numër telefoni** \_\_\_\_\_ **fax** \_\_\_\_\_

**e-mail** \_\_\_\_\_ **ueb-faqe** \_\_\_\_\_

**si organizatë** \_\_\_\_\_ **e regjistruar ne Kosovë** (dëshmuar me kopjen e dokumentit të regjistrimit)

**Nominon për anëtarë të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës:**

---

*(emri dhe mbiemri i të nominuarit)*

---

**Nënshkrimi i përfaqësuesit te Organizatës**

**VULA e Organizatës**

**Data**



## Formulari i deklaratës së të nominuarit

Unë,

\_\_\_\_\_

[shëno emrin dhe mbiemrin me shkronja të shtypit]

me vendbanim në \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_

numër telefoni \_\_\_\_\_ mobili \_\_\_\_\_

fax \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_

si banor i ligjshëm i Kosovës (dëshmuar me kopjen e dokumentit të identifikimit)

**DEKLAROJ se Pajtohem që të nominohem nga**

\_\_\_\_\_

[emri i individit / organizatës si nominues]

**për Anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.**

**Unë jam plotësisht i vetëdijshëm për përmbajtjen e nenit 27 të LIGJIT Nr. 04/L-046 dhe deklaroj se nuk ka pengesa ligjore për emërimin tim për Anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.**

\_\_\_\_\_

**Nënshkrimi**

**Data**

## Formulari i deklaratës së të vetënominarit

Unë,

\_\_\_\_\_

[shëno emrin dhe mbiemrin me shkronja të shtypit]

me vendbanim në \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_

numër \_\_\_\_ telefoni \_\_\_\_\_ mobili \_\_\_\_\_

fax \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_

si banor i ligjshëm i Kosovës (dëshmuar me kopjen e dokumentit të identifikimit)

***Vetënominohem për Anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.***

**Unë jam plotësisht i vetëdijshëm për përmbajtjen e nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-046 dhe deklaroj se nuk ka pengesa ligjore për emërimin tim për Anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.  
Kësaj shkrese ia bashkëngjes tërë dokumentacionin e kërkuar në shpalljen publike.**

\_\_\_\_\_

[Nënshkrimi i të vetënominarit]

Data